



Frazeologjia në satirën e Gjergj Fishtës

Meri Markiçi

Faculty of History and Philology, University of Tirana, Albania

Editor, Academy of Sciences of Albania, Tirana, Albania

Abstract

Në këtë artikull do të përpiqemi ta shohim Gjergj Fishtë, sa i shquar për epikën epike që krijoi dhe e ngriti një monument letrar, aq është i pashembullt, ndoshta i paarritshëm, në llojin e satirës therëse, ironike dhe depërtuese e shkatërruese që sjell në poemat e veta. Del në pah se burimi i frazeologjizmave të përdorura nga Fishta, përveç atyre që rrjedhin nga hapësira e Gropës së Shkodrës, janë edhe nga vendlindja e tij, Fishta (Zadrima) ku lindi e u formua gjuhësisht në hapat e parë të jetës. Kërkimi përqendrohet kryesisht tek trashëgimi letrar i poetit duke vështruar njësitë frazeologjike, jo aq për shumësinë dhe dendurinë e praninë, por kryesisht për rolin e tyre në karakterizimin e personazheve, karaktereve letrare, në vepra themelore, si “Gomari i Babatasit” dhe poema të tjera satirike nga përmbledhja e para një shekulli “Anzat e Parnasit”, “Gjuha e mësimit”, “Makaronjana”, etj. Frazeologjizmat satirike natyrisht, do të jenë të ndryshme nga njësi frazeologjike në krijimet epike. Ndërkohë, është vënë në dukje gjatë punimit se Fishta përdor me mjeshtri të lartë njësitë frazeologjike, jo aq për vendin ku i sjell, por për teknikën e lartë poetike që zotëron.

Keywords: satirë, njësi frazeologjike, karakterizim i personazheve, aforizma, maxima

1. Introduction

Do të kishin mjaftuar krijimet në satirë, që Gjergj Fishta të ishte ai që është, Gjergj Fishtë i letërsisë shqiptare, edhe pse poeti hartoi vepra edhe në gjini të tjera, si në epikë, lirikë dhe dramatikë, pa përfshirë këtu, në opusin e tij, publicistikën^[1], teorinë e letërsisë (estetikën), epistolarin e pasur, të pambledhur e të pabotuar deri më tash; të autorit të “Lahutës së Malcis”, janë gjithashtu edhe traktet apologetike, si “Shqyptarët dhe të drejtat e tyre”^[2], Përveç artikujve polemikë: “A janë të zotët shqiptarët me u mbajtë shtet më vete?”, “Kanibalizmi sllav ose vdekja e shëmtueme e P.Luigj Paliqit”, “Tash, qi është bā Shqipnia, duhen perbā shqiptarët”, “Vjersha heroike shqiptare”, “Kur do të bashkohen shqiptarët”, “Nji komedi e pandershme e XX qindvjet”, etj., etj.

Studimet për letërsinë e krijuar në lëmë të satirës, kanë përcaktuar se humori, ironia, sarkazma, etj., janë produkt i zhvillimit në shkallë të lartë dhe emancipues të shoqërisë njerëzore. Veprat satirike u shkruan fort më vonë se drama, tragjedia, kurse komedia greke lindi në epokën më të ndritur të qytetërimit helen, kur qenë hedhur bazat kryesore të dijeve, kur qe krijuar një republikë demokratike, kur kufijtë e shprehjes kishin arritur kufij të tillë, që mjaft vende të botës

s'i kanë sot e kësaj dite^[3]. Mesjeta nuk krijoi kushte të emancipimit shoqëror siç e kërkonte gjenerimi i veprave satirike, prandaj dhe shekujt e saj nuk njohin zhvillimin e veprave të humorit e satirës. Për këtë, letërsia satirike shqiptare dha modele vetëm pas 350 vjetë letërsie, dhe vepra e parë e plotë e saj “Anzat e Parnasit” e botuar më 1907 nga Gj.Fishta, sipas S.Çapalikut, del në dritë pikërisht kur shoqëria shqiptare ishte formuar në pikëpamje psikologjike, kulturore e politike^[4]. Nuk na lejohet të shmangemi nga objekti i punës sonë, në planin gjuhësor, për hulumtimin e frazeologjizmave të autorëve të përcaktuar, por, për Fishtë duhet theksuar se ai hyri në rrafshin e regjistrin shprehës të satirës me njohje të zhvillimit të këtij lloji letrar që nga antikiteti grek e romak, deri tek trashëgimi letrar i vendeve evropiane, përndryshe i literaturës së këtyre popujve, në rrafshin e satirës, sidomos nga letërsia italiane, franceze, me autorët e tyre në zë e me veprat e krijuara. Ernest Koliqi ka vërejtur se me françeskaj, gjuha e popullit, në daç si frazeologji idiomatike, në daç si endje vetjake trajtash, shprehesh e merr zyrtarisht, të themi pagëzimin e melanit (mereqepit)^[5].

Si në gjinitë e llojet e tjera letrare që lëvroi, Gj.Fishta, edhe në satirë, mbeti përgjatë gjithë jetës në përpjekje me poezinë popullore, të cilën e njohu aq mirë e në thellësi, saqë mundi të vjelë prej saj visare të çmuara, që e dallojnë në shenjë midis krijuesve të tjerë kohanikë, por edhe para e pas largimit të tij

¹ Përveç themelues dhe drejtues e revistës së njohur “Hylli i dritës”, Fishta ka qenë për 3 vjet edhe bashkëdrejtor – me albanologun austriak Max Lambertz – i gazetës dygjuhëshe: shqip-gjermanisht “Posta e Shqypniës”, ku ka shumë shkrime. (5 Dhetuer 1916- 23 Nanduer 1918).

² Fishta, Gjergj. Shqyptarët dhe të drejtat e tyre, Shkodër, Shtypshkroja Françeskane, 1920.

³ Çapaliku, Stefan. Fishta satirik, Shtypshkronja “Volaj”, Shkodër, 1995, f. 22.

⁴ Po ai, po aty, f. 23.

⁵ Koliqi, Ernest. Shkolla letrare e françeskajvet, L’Albanie librè, korrik 1956 (Citohet sipas S.Çapalikut në veprën e cituar më lart).

nga letërsia. Nëpër satira të veta Fishta bën polemikë me qeveritarë, ministra e drejtorë, polemizon me gazetarë e shkrimtarë, është kur i vjen rasti, edhe apologjet i Shqipërisë para Europës e mbarë botës, del kundërshtar me sivëllezër klerikë, bile edhe të urdhrat të vet (O.F.M.), sillet ashpër e bëhet idhnak; papritmas u lëmon kryet me gjuhë satire njerëzve të pa meritë në punët e shtetit; herë-herë shpotit, tall e luan harushë, edhe dërrmon keqas e damkos tradhtarë e parazitë të shoqërisë shqiptare të kohës së tij. Mund të shprehim mendimin se një krijues, nuk bëhet satirik në vepra, as për hir të traditës që njej, as falë studimeve letrare në plan kombëtar e më gjerë, por dhuntia për këtë përkatësi, Fishtës i vjen më së pari nga trashëgimia dhe mjedisi ku ka lindur, deri tek fisi dhe familja. Nëse pyet dikush për humorin zadrivor dhe brenda tij për anekdotat e fshatit Fishtë, mes të cilit për fisin dhe familjen e Zefit që u bë Gjergj në udhën e Shën Françeskut, para disa brezash, i kanë treguar se kjo hapësirë e prej shekujsh, ka disa veçori të dukshme gjuhësore, në qendër të të cilave është humori i hollë, fjala e mënçur dhe situata gazmore, pa asnjë pasojë shërri e hatërmbetjeje.

2. Veprat satirike të Fishtës

Vepra satirë e Fishtës, dhe ndër të parat, pas disa poezive adhetare, është përmbledhja “Anzat e Parnasit (1907), ku përfshihen: *Nakdomonicipedia*, *Metamorphosis*, *Gjuha e mësimit*, *Nevoja e mësimit*, *Bujari*, *Dredha e djallit*, *Dijsja*, *Palokë Cuca*, etj., që kanë strukturë dhe fabul poemash, bashkë me *Nikolejda*, *Taralloqja e Ballkanit*, *Makeronjana*; disa poezi të gjata, si: *Kur pata qenë ba Papë*, *Barabba*, etj.

“Anzat” kanë disa poema përmasash të ndryshme për nga ana sasiore e vargjeve, por, ajo që ka rëndësi për një kërkim gjuhësor si ky yni, është se tematikat e ndryshme kanë bërë që të ndryshojnë edhe regjistrat gjuhësorë, në varësi të tyre edhe tipat e frazeologjizmave, pasi në fillim Fishta vë nivelin për rrafshin intelektual në Shqipëri: sa përthithen veprat e artit, sa shkojnë ato deri në popull dhe çfarë vlere kanë artistët për një vend si vendi ynë. E tillë është *Nakdomonicipedia*, e cila merr si model krijuesi shkrimtarin Ndoc Nikaj, jo i urdhrat françeskan, por meshtar shekullar, siç quhen një pjesë e klerit. Ka kjo poemë 4 pjesë, të cilat emërtohen me maksima apo aforizma: *Fecit indignatio versum* (Vargu doli prej indignatës, se, me të vërtetë Poeti lë gjurmë të revoltës dhe indinjimit ndaj fatit të intelektualit të vërtetë në shoqërinë shqiptare); pjesa II ka për titull një distik proverbial – një krijim të vetë Poetit: *Me t’pvetë kush se ç’ishte jeta/Mik e fis, thuej, këtu asht kuleta!* – gjithë “urtësia” e kësaj pjesë vihet në gojën e një personazhi të komedisë franceze, në gojë të Tartufit, nga komedia homonime e Molierit; pjesa III përmban këshilla miku për *Nakdo Monicin*, kurse pjesa IV, që mbyll ciklin satirik të kësaj poeme (shkruar 110 vjet më parë), mban për titull një varg të poetit të madh romak, Virgjilit “Tros Tyriusve mihi nullo/discrimine habentur”.* Si u tha më lart, përmbajtjet janë ato që kushtëzojnë regjistrat e gjuhës së Poetit dhe, për vështrimin tonë, edhe mjaft njësi frazeologjike të diferencuara midis tyre. Kështu, tek vargjet e indignatës që shfren autori, ndaj shikimit menefrego që i bën shoqëria dom Ndocit, shkrimtar i romaneve të para në shqip, dhe botues në “shtampen” (shtypshkronjën) e tij, gjejmë:

- *si ecë “cicmici”* – “S’ di si ecë n’ketë jetë cicmici” – nuk di si luhet loja e jetës, nuk di të

- orientohesh në shoqërinë e kohës;
- *të hajë palla* – këtu: të thotë mendja: “Qysh se ty mund ta hajë palla/ Se po kape n’breg me përralla”; të rren mendja se ia del punës dhe vetë jetës me ato që shkruan, po del në breg, sepse “n’ujë të pafund je”;
- *tue vu mbi letra* – duke shkruar ato histori tuat për Shqipërinë;
- *fiton të zitë* – fiton vetëm të zezën tënde, me shformim të frazeologjizmit “Se çka të zitë ti ke fitue”; nuk fiton asgjë;

Për të mbërritur deri tek frazeologjizmi i qëlluar, Fishës, shpesh herë i duhet të ndërtojë figurshëm disa vargje radhazi, si në shembullin më poshtë, f. 12:

*“N’hatull t’truve te kaptina Due me thanë, kem’zi urtie,
Ka’i drrasë mangut t’gjith’e kina: Pse e kem’t’gjithë ka’i
rrem marrie.*


Njeriu me kokë (kaptinë) vjen e shihet si një shtëpi, me çati e hatulla prej dërrase, nga numërimi i të cilave, secili nesh ka mangësi; ose ndryshe: edhe *rrem- degë*, marrie;

Ose, kufizuar brenda dy vargjeve, merr e rreshton edhe nga dy njësi frazeologjike, si vijon: *Por këtu vetë s’po due me i djerrë./Hollë e gjatë tue dashtë m’e tjerrë*, ku dalin në dukje formime nëpërmjet një foljeje, si me “tjerr” dhe “bluen”, duke ndërruar vetëm ndajfoljet, pa përmendur termat “fije” dhe “miell”, nga e kanë bazën e burimit:



- *vë në rabush* – vë në hesap, vë në llogari, e llogaris; zakonisht në fjali mohimi;
- *shoh seri me sy* – shoh çudira me sy, shoh habi; habitem, çuditem; (seri-tq.);
- *s’i xe vendi vend* – nuk mund të rrinë në një vend, janë kaq të paqëndrueshëm;

Shihen te poetika fishtjane edhe dyzime për të gjeneruar njësi frazeologjike mbi bazën e dy a më tepër foljeve, rrjedhur mbase nga një anekdotë, si:



- *u dha zani* – u dëgjua, u muar vesh një lajm për një ngjarje e veprim;
- *flas rend e rend* – flas sipas radhës a serës së kuvendit;
- *jap pazar* – vë një çmim mallit, e vlerësoj; e mbaj një mall para blerësve në treg;

Në pjesën II ku po vjelim, Poeti ka ndërruar masën metrike, ka

kaluar në 6-rrokësh përgjithësisht, kështu që nuk e ka hapësirën e shtrirjes së frazeologjizmeve, kështu që është i detyruar, brenda këtyre masave, t'i shpërbëjë më së shumti frazeologjizmat, ndryshe t'i shtrijë ato në dy – tre e më tepër vargje:

- *shkon lëmuet jetën* – kalon jetën pa vështirësi, i ecën jeta mbarë e bukur;
- *e ka të nxehtë kuletën* - e shpërbërë: “N’daç t’nxhetë m’e pasë/Gjithmonë kuletën”, nëse dëshiron të kesh përherë para, pasuri, kamje;
- *strukë nën sqetull* – fshehur nën mbrojtjen e dikujt: “E t’medhejt’nën sqetull/Ty kanë me t’strukë”;
- *ta këndon dëfterin* – ta lexon, ta njeh mendimin;

Tek Metamorphosis e pjesës IV ndërron përsëri masa metrike, në 6-rrokësh, duke ngushtuar hapësirën e frazeologjizmeve, prandaj dhe i gjejmë të shtrira përgjatë vargjeve, deri në kufijtë e strofave dhe më tej, pasi autori e ka shtruar poezinë në monokolonë, por duke ruajtur në njëfarë mënyre organizimin sintaksor të strofave katërshe:

- *nuk i thirret dërrit dajë* – në dy vargje: me një fjalë si klauzolë e vargut II “thirret” dhe sintagma “dërrit dajë” në vargun IV. Po kështu ngjet edhe me frazeologjizmin tjetër:
- *i hyn lepuri n’bark* – e zë frika, frikësohet tepër; shtrirë në dy vargje: “Se mue m’ka hi/Sot lepuri n’bark”;
- *i bahet zemra shtupë* – i mblidhet tutël, i mblidhet lëmsh zemra prej friket;
- *hidhet si hut në përroskë* – lihet veçmas si gjë pa vlerë, pa rëndësi;
- *rrin në shkam* – rrin në shkamb, Këtu: rrin në pozitë, ka poste qeveritare;

Tek “Gjuha e mësimit” dallojmë një krijim dramatik në dy pjesë (tjetra titullohet “Nevoja e mësimit”), hartuar para 99 vjetëve, për ceremoninë e ndarjes së çmimeve të Shkollës Françeskane, ku Fishta ishte Drejtor (Ai futi mësimin në shqip për herë të parë), vjen në diferencë gjuha e personazheve: Ndreka, Gaspri e Prendi – qytetarë shkodoranë, të cilëve Poeti u ka ndarë si me hisë mendësinë për rëndësi të mësimit, shkollës dhe arsimimit të fëmijëve e të rinjve. Replikat janë shtruar në monokolonë, me rimë, por metri i tyre nuk del konsekuent...derisa, papritmas, poeti ndërron mendje dhe vendos me dalë tek proza, duke nisur me italianin C.Cantu... e gjer në mbyllje të pjesës...është gjithë kjo një mënyrë sjellje komike e autorit...

Autori nis monologun e Ndrekës me një aforizëm “*Fillimi i mbarë – gjysma e punës*”, siç vjen me elipsë të foljes, për një efekt më të dukshëm stili, por që zë hapësirën e dy vargjeve: “*Pse mbarë punën me e fillue/Do me thanë për gjysmë me e çue*” e në vijim:


- *ia çoj trutë në vend* – i sjell arsyen, mendimin e drejtë; e bind, zakonisht edhe me anë
- dënimesh të ndryshme, ndërsa është fjala për jetën shkollorë;
- *janë gur e unuer* – janë gur stralli dhe një metal që, kur fërkohen, nxjerrin xixa: janë zemërakë – gati me u zënë njëri me tjetrin, gati të qesin flakë e shkëndia; kënde duket se vjen edhe shprehja e gjuhës së folur “asht çakmak” – është gjaknxehtë, gati të shpërthejë flakë.

Njësi të tilla hyjnë në grupin e njësive frazeologjike *episodike* të lidhura me bashkërenditje me nuanca kurative, siç është, b.f.: “në këmbë e në dorë”, “sot për nesër”, etj., të cilat përbëjnë shkallën e parë të frazeologjisë gjuhësore.

- *i vë fjalët në rabush* – i llogarit fjalët, i sheh në kuptimin e tyre, i sënnon dhe jep përgjigje
- jo të mira e me respekt, por siç thotë populli “hazërxhevap”;

Pjesa II “Nevoja e mësimit” zë e kthehet në replika në gjuhën shqipe, kur flet i pari Ndreka, një personazh, mbi të cilin autori ka derdhur gjithë simpatitë e vete, e ka dalluar në shenjë për mençuri dhe vë në gojën e tij mjaft frazeologjizma e shprehje gjuhësore, të cilat e veçojnë atë edhe në idiomën personale; tek replikat monologje të gjata të Ndrekës gjejmë edhe krijime tepër të rralla dhe jo aq të njohura, të cilat edhe është vështirë të zbërthehen pa kontekstin jo vetëm të oratorisë së tij, por as pa ndihmën e tjetrit bashkëbisedues apo, pa ndërhyrjen e vetë autorit. Si këto, mund të rreshtojmë:

- *kam ra n’gjak me kuletën* – më asht shpue kuleta; s’kam asnjë dysh, më është bërë petë;
- *kuletat i kanë djerr* – nuk kanë asgjë në kuletë; nuk kanë nevojë t’ hapin, i mbajnë
- mbyllur, sepse s’kanë asnjë dysh brenda (“djerr-i” tokë e papunuar);
- *kapem larg* (me këto bejte në vargje) – më qesin larg, më krijojnë probleme e telashe;
- *baj hije mbi tokë* – jetoj sidokudo, gjalloj ose mbijetoj me vështirësi;
- *mendtë t’jan ba nishan* – të janë mendtë dekoratë; je fiksuar në diçka; kemi parë se me foljen “baj” në të gjitha kohët e mënyrat, mund të gjenerohen me dhjetëra e dhjetëra frazeologji, duke i shtuar asaj emra gjithfarësh, sipas situatës kumtuese:



Jani Thomai ka vërejtur se disa njësi frazeologjike të gjuhës shqipe kanë barazvlerësit e tyre delokutivë (fjalë të formuara nga përngjitja e gjymtyrëve të një lokucioni), siç del qartë kjo në rastet vë re – vërej, baj za – bëzaj, zë vendin – zëvendësoj [6].

Tek poema “Bujari” na vjen papritur skena migjeniane [7] e një gruaje të ve malësore, që ulet në Shkodër, me dy fëmijë të uritur dhe historia e saj e trishtuar. Nuk na shfaqet tregimi në vargje gjithë satirë, por përshkohet edhe prej tragjikes.

⁶ Thomai, Jani, Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe, Monografi, Tiranë, 1981, f. 38. (Më tej gjuhëtari ynë shtjellon: “*Formimi i njësive frazeologjike më i hershëm se fjala, që është sinonim me të, është i mundur edhe për rastet kur sinonimi nuk del nga përngjitja e gjymtyrëve të njësive frazeologjike, por vetëm duke u nisur nga njëra gjymtyrë.*” F. 38.

⁷ Migjeni, Migjeni, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1988, f. 21. (Ja vargjet e Migjenit: “*Kafshatë që s’kapërdihet asht, or vlla, mjerimi, Kafshatë që të mbetë në fyt edhe të zë trishtimi/kur shef fyra të zbeta edhe sy të jeshilta, që të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita ..., f. 21)*

Gjithçka vjen e tregohet nëpërmjet *Autorit* (në Parathanie) – *Gjyshit – Tatës – Djalit*. Është parathënia e autorit një tekst i ngritur gjuhësisht shtruar në vargje të matura, ku sintagmat poetike zënë vendin kryesor, me lidhje valencash në grupe të poetizuara, si: *pat qenë vendue* – u regjistrua; *me zanë shkollë* – të mësojë shkollë – të arsimohet; ose: i vjen marre – *marrohet* (turpërohet). Përgjatë vargjeve ndeshim edhe segmente të tilla që edhe sot të habisin me mjeshtërinë e shprehjes poetike, si: “Tash s’di se kur ra n’Shkodër një malcore:

Me ‘i djalë pesë vjeç e me një vajzë për gji,
Kaliboç vajzën, djalin marrë për dore.
Ra, e mjera, n’Shkodër për me lypë me fëmijë....
Filloi me lypë për rrugë edhe për shpia,
Me ato dy fëmijë, t’dy f’ tyre si uja zbe.” (F. 92)

Për këto njësi J.Thomai shkruan: “Disa njësi frazeologjike të gjuhës shqipe kanë barasvlerësit e tyre delokutivë (fjalë të formuara nga përngjitja e gjymtyrëve të një lokucioni), siç del qartë kjo në rastet vë re – vërej; baj za – bëzaj etj...”^[8] Gjejmë brenda këtij teksti: *mendtë e holla, u vu për fije* – ktheu mbarë, *ndien toka shqiptare, vjen tue nga* – vjen duke vrapuar, *çak der’n’t parën kore* – qysh prej brezit të parë; parathënia vjen si shtrati i temës që do të trajtojë Poeti përgjatë fabulës, e cila nuk mbahet vetëm nga një person, por sikur baraspeshohet në tri vetje (persona), të cilët edhe kanë “lirinë” e përbërësve frazeologjikë, të ndryshme sipas aktorëve të kallëzimit në vargje:

- *ra në Shkodër* – vetë folja “ra” tregon se malësorja bie poshtë në qytet nga malet; diku tjetër, autori ka përdorur foljen sinonime, që shpreh të njëjtën gjë: “u ul (ulet) në Shkodër;
- *vajzë për gji* – fëmijë ferishte që pi ende gji, fëmijë gjiu, nuk ushqehet me gjellë të tjera;
- *e çoi me zanë letër* - e çoi të zërë shkollë, e futi në shkollë, e dërgoi për studime;
- *e shkoi jetën qençe* – e kaloi jetën me të keq, duke vuajtur, pa harmoni me të tjerët;

Përgjatë frazemave, Fishta merr e sjell midis vargjeve edhe ndonjë aforizëm popullor, që vihet në fabul për të karakterizuar për së tepërmi një person, siç bën me studentin e padenjë që kthehet në vendlindje, pa mbaruar as shkollë, as mjeshtri, vjen si shumë të tjerë tek Nana-Shqipëri, e cila priste njerëz të mbarë e të formuar, po i vijnë gjithfarësh:

“Qit tash pushkë moj Shqiptari
Ke sot n’gji po t’kthen kjo lule!
Si po t’kthen as vetë s’po e di...
Pat shkue arkë, po t’kthen baule...” - pat shkue me fjalë e me synime të mëdha, veçse po vjen tepër i pakët në arritjet e synimet e veta.

Pa ndërruar vështrimin tonë, themi se autori ynë, përherë për humor, merr e ndërron edhe rendin e përbërësve të aforizmave; kështu kemi ndeshur variantin e shndërruar të njësisë - - *Hall me vdekë e gjyq me mbetë*” - në: “*Hall me*

rrune e gjyq me dekë”. Edhe aforizmi - “*Bostanxhisë s’i shiten kastraveca*” vihet në këtë radhë, me kuptimin: s’duhen bërë punë pa mend; nuk duhet trokitur atje ku nuk duhet, Bostanxhiu i prodhon vetë të dyja;

- *derdh dije* – shpërndan dituri, përhap shkencë (gjithnjë studenti i dështuar sa kthehet);

Edhe Fishta, si mjaft intelektualë dhe artistë të tjerë, është krijuar aforizmas, të cilat, prej tij si krijuar, vijnë të poetizuara, siç vepron në vargjet: “*Dredha e djallit, pse s’asht tjetër,/Si e kam këndue ndër libra t’vjetër,/Veç padija dhe krenaja,/Që shkojn’ngjitë si trupi e hija.*” (f. 165).

Veçse, te poetë si Fishta, ndodh që të shkrihen së bashku brenda një vargu edhe dy frazeologjizma në vijim, si: “Pa i matë fjalët, ti mos i qit për fushë” – bart kuptimin: pa menduar, mos e nrrit fjalën nga goja. Për këto njësi që dalin më së shumti vetëm me kuptim mohues, si: *s’lë dy gurë bashkë, s’e ha atë kokërr ulliri, s’turbullon ujë*, etj., Jani Thomai, shkruan në monografinë e cituar këtu: “*ndonjëherë trajta mohuese me atë pohuese kanë edhe dallime kuptimi, p.sh.: të ka hije – të rri bukur; s’të ka hije – nuk është mirë për ty të veprësh kështu....Të gjitha njësitë frazeologjike foljore që përdoren vetëm në trajtë mohuese, kanë në vetvete përmbajtje mohuese, edhe kur dalin në fjali pyetëse retorike, p.sh. Pse lë dy gurë bashkë ai?*”^[9]

- *mos me dashtë me mbetë krejt n’zallë* – me elipsë të emrit “peshku” dhe të lidhëzës “si”:
- me mbetë si peshku; që të mos mbetesh pa asnjë kusht jetese - “si peshku në zall”;
- *thahet në shulla* – ter rrobat në një vend shullë-ri, pasi është lagur;
- Te “Palokë Cuca” – një hero komik aq popullor në Shkodër, ravizuar nga pena e Poetit, bëhet përpjekje, siç shkruan Fishta, për “një provë poemi herojkomik”^[10], me shprehjet:
- *ban gjuhën çakalle*- bëhet llafazan, zë e flet shumë e shpejt, si çakallja e mullirit;
- *me tjerë tortë* – me e zgjatë për së tepërmi fjalën a bisedën; këtu: këngën;
- *gjuhë mushkë* – gjuhë që nuk gjeneron, nuk pjell e nuk zhvillohet, ashtu si mushka
- shterpë. Ka edhe frazeologji që ngrihen mbi anekdota e që Fishta i sjell nëpër vargje:
- *del gomar i Nastradinit* - del i dobishëm, del me fitim të madh (sipas anekdotës që në
- vend të plehut, bënte florinj!)
- *me i ndërrue ftyrë* (gjuhës së mësimit) – me i ndërrue pamje e trajtë, edhe drejtim;

Përgjatë poemës herokomike “Palokë Cuca”, autori përfton edhe shprehje aq të lidhura me antonime, ku vijnë e bashkohen përbërës pa mundësi valence, siç i gjejmë në distikun më poshtë: “Përse të gjithëve ai *dinte mirë me u ardhë/Njenit një rrenë të kuqe e tjetrit të bardhë*”, f. 207. Shprehja e nënvizuar bart kuptimin “dinte me u sjellë me njerëzit” sipas kërkesave e karakterit të secilit. Po kështu sinonimia e frazeologjizmeve edhe për shkak të eufemizmave,

⁸ Thomai, Jani. Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe, Tiranë, 1981, f. 38.

⁹ Thomai, Jani. Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe, Monografi, Tiranë, 1981, f. 113-114.

¹⁰ Fishta, Gjergj. Vepra – 7, Botimet Fishta, Lezhë, 2004, f. 192 – 266.

i gjeneron Poetit shprehësi të veçantë, si tek modelet: “...me marrë frymë harroi/ E vdiq e shkoi, porsì të mos t’kishte qenë.”

- *i vë buza shkrumb* – i thahet buza: nuk pi, as ha, por as pushon së foluri;
- *ndër mend ish e pa kandar* – ishte në mendje jo kursimtar, nuk e njihte masën e kursimeve as të shpenzimeve;


☐- *zen me djerrue* – fillon të vrasë mendjen për të arritur diçka: “*Po zen për pun t’mirasit me djerrue*”, (f. 209). Në frazeologjizma si ky dhe të tjerë që përdorin, sidomos poetët në strukturat e vargjeve, kemi nënvizuar se ato shfaqen edhe të ndërmjetuara me elemente apo gjymtyrë të tjera, që e shformojnë shprehjen në një farë mënyre; megjithatë, këtu evidentojmë njësi pa këto ndërmjetime, për të cilat në teorinë e frazeologjizmeve, vjen shpjegimi i mëposhtëm: “*Shpeshherë, kur njësitë frazeologjike hyjnë në fjali të ndryshme, jo vetëm nuk e ruajnë rendin e fjalëve të gjedheve të tyre fillestare, por edhe mund të shpërbëhen, meqenëse këputet lidhja, njësimi kuptimor dhe gramatikor: gjymtyrët e tyre mund të kryejnë funksione të ndryshme brenda në fjali ose në fjali të ndryshme.*”^[11] Asnjë krijues nuk do të dëshironte të prishte strukturën e frazemës, por ndërmjetimi duhet të jetë në segmente të shkurtëra, aq sa lidhjet e përbërësve të frazeologjizmit të mos kalojnë distancën që nuk prek semantikën. Bie fjala, frazeologjizmi “*t’u bie kush në dorë*” f. 211- ka ndërmjetim të një përemri me funksion kryefjale, por që nuk këput lidhjet semantike të njësisë së togut, ose: *kuleta i mbet si duqe** - “*I mbet si duqe t’ngratit n’gji kuleta*”, ku mbiemri “*t’ngratit*” dhe sintagma parafjalore (SP) n’gji – janë të ndërmjetuar.

- *veshët i qiti në lesh* - bëri sikur nuk dëgjoi, heshti qëllimisht;
- *u ndanë me ‘i grusht mushkaja* – u ndanë pa marrë asgjë “*E emta e nipi u ndan me ‘i.*”;
- *nuk i resh fati* – nuk i afrohet fati, nuk i qaset;

Tek poemi i shkurtë satirik “*Taralloqja e Ballkanit*” *autori ka sjellë aforizma a fjalë të urta të gatshme për t’i përfshirë në vargje dhe rrallë herë bën shformime të lehta përgjatë monokolonës, strukturë poetike, me të cilën ka thurur poemthin më lart; prandaj dhe gjejmë sintagma e fjali vënë në gojën e personazheve historikë, nga Knjazi i Malit të Zi, deri tek Esat Pasha, Kapidani i Mirditës, Haxhi Zeka dhe Mbretërit Ballkanit:

- *kishin mbetë havale* – i kishin mbetur bezdi, mërzi, gapërr;
- *u shkund kulete* – mbeti trokë, mbeti pa asnjë dysh;
- *borxhit i bie hasha* – mohon borxhin dhe nuk e shlyen;
- *i shtie dy kambët në një këpucë* – e shtrëngon, e zë ngusht;
- *kish ra pykë* – del edhe “mbeti pykë”, “u gjend pykë”- të gjitha me kuptim të njëjtë: ndodhej ngusht; këtu: në pikë të hallit;


¹¹ Thomai, Jani. Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe, Monografi, Tiranë, 1981, f. 54.



gjenerohen dy frazeologjizma sinonimike, si variante me të njëjtin kuptim: heshtjen.

- *i kandej me shoshitë* – i pëlqente me rrahë çashtje e me nxjerrë përfundime: E me shoshitë i kandej të parë e të mbramë;
- *t’i vente dorë Pal edhe Palush* – ia hynte e fliste për Pal e Palush: për të gjithë njerëzit;

Edhe te Fishta, si tek krijues të tjerë të Shkollës Françeskane (emërtuar kështu nga studiues të ndryshëm, qysh nga Koliqi), shprehje të ndryshme, frazeologjizma, shprehje paremiologjike, si: fjalë të urta, maksima dhe endiada japin shprehësi dhe luejnë një rol të dukshëm, njëherësh, vetëm po të shihen në strukturën e frazave, por edhe në hapësirën e mbarë të strofave, si në shembullin në vazhdim, ku mjetet leksikologjike të dhëna më lart, përhapen përgjatë gjithë tekstit poetik:



Krijues si Fishta, edhe me një kompozitë të rrallë endocentrike, siç formon fjalën karakterizuese “*fytyrëgjuhëlopa*”, sjell shprehësi jo vetëm për një varg, por për gjithë strofën (f. 244).

Ndodh në poetikën satirë të Fishtës që edhe foljet enumerative (endiadë) të lidhen nëpërmjet dukurisë së tejkalimit (l’enjambement), si në dy vargjet e mëposhtme të *poemit herojkomik*: “*Iu gërmush mësuesi, atëbotë; përse në basha*

☐ Me u ardhë atje, po u ndrydh si dy brasha.” (f. 261)

Te poema satirike “*Taralloqja e Ballkanit*” Fishta sjell nivele të veçanta frazeologjizmesh, me fjalë të urta, proverba, endiada e maksima, të cilat shfaqin edhe rrafshin kulturor të atyre që i shqiptojnë, që i përdorin edhe në kontekste të veçanta, me thënie vulgare jo aq të ngritura dhe aspak poetike ose nuk arrijnë të poetizohen (p.sh.: *zemra i hjek, diçka s’i ban, kush bie me qen, çohet me pleshta, hunda jote sa ‘i samar/që s’ta lanë me hanger bar; Knjaz Danili “vërt” e “tërt”; Do skopaj me u prekë kryet n’tra/Që me t’trembë n’andërr me i pa; flokët e gjata e mendët e shkurta; jam n’cetinë si qeni n’qerr*) siç mund të dallojmë:

- *t’ia shtijnë t’dy kambët n’një këpucë* - ta shtrëngojmë së tepërmi për ta bindur a për ta detyruar për një punë ose veprim që s’do apo nuk arrin ta zbatojë;
- *shtroj pengun* - shprehje frazeologjike, lindur sipas një zakoni kanunor, kur gjëja lihet në dorë të kreditorit për të

siguruar të larët e borxhit: “Iu desht Nikollës pengun me e shtruar”. (f. 305).

Tek poemthi satirik “Makeronjana”, qysh në kushtim të saj, vëmë re se sillen shprehje e frazeologjizma të një klase tjetër, të një niveli tjetër, jo vetëm më intelektual, por edhe si të përziera me italishten dhe mendësinë e folësve të saj; çdo lexues mund të dallojë se sintagma emërore-satirë “*pasticcio poetik*” vjen nga përtej detit, kurse sintagma tjetër parafjalore (SP) “*me rroc e koc*” ka si të thuash, taban të gjuhës shqipe. Do të na mjaftonte fraza-kushtesë, me atë thurje leksikore dhe sintaksore të jashtëzakonshme, hartuar në vargje të parimuara, por me kompozita qesharake, me të cilat Poeti vë në lojë e ironizon me sarkazëm të huajt dhe bashkatdhetarët e vet:

“Kalangerça, burreca të huej- që me gj. e huaja u trodhen shqipt. tru e zemër u kërtlyën n’vjam; “kambëspilca”

- pështetë në shtasësi të shqiptarëve ndër shkolla, të dilnin jo-shqiptarë.

Radhazi shfaqen edhe frazeologjizma në poezinë monokolonë, satirë e poemthit, por duke i sjellë gjithnjë në kontekst:

*“Jo, po, vetë kët’punë e di; Me pak pare e me shum’dokrra
Por me kohë e me dredhi (362) Rrânë shqiptarët si pulat n’kokrra.*

Ndër satirat më të mira, që janë përfshirë në Veprën – 7 të Poetit (vepër me titull “Anzat e Parnasit”), dallojnë “Kur pata kenë ba Papë” (kushtuar P.Anton Harapit), vjersha “Vegim” (me kushtesë ndaj P.Pashko Bardhit O.F.M.), vjersha “Dreqënt e dom Ndreut” (kushtuar P.Marin Sirdanit); dialogët “Si i do mushka drutë” – titull frazeologji – “Në vdekje të Frano Krispit (për A. Ciril Canin O.F.M.), Vjersha “Barabba”, kushtuar “Fort të ndertit Atë Seferin Lushaj O.F.M.) dhe vjersha e improvizuar titulluar “Fort të ndertit Z.D.Ndre Mjedës” që mbyll ciklin e satirave të vëllimit. Ka mjaft frazeologjizma në këto krijime pamflete. Mund të zgjedhim shprehjet më të goditura, si:

- m’u ba mendja lepër – tue rrue petulla n’Shqipni – i dredhsha lakun (në fyt) – u dhashë det e u dhashë mal (jezuitëve të huej) – t’i hodha vandak (fretit e huej) – plakat e dheut i treta (murgeshat e huaja) – me dru me ua qa t’amen – pa dru s’u mbushet rrashta (koka) – nuk ndez fjala – rrahin ujë n’havan – na nxore doret (tregtinë).

3. Karakterizimi me frazeologjizma në satirë

Pohojmë që në fillim se në fushë të paremiologjisë, maximat apo aforizmat, luajnë një rol të veçantë në lëmë të satirës; për shembull, tek kallëzimi në vargje “Dijjsja”, Fishta luan aq bukur me *maksimën*^[12] “Dhima e burrit – dhima e brryllit/që

dhemb shumë e kalon shpejt” (e cila, kështu e rimuar, duket se është një formim i Fishtës, edhe për faktin se mbahet në kujtesë dhe përdoret si aforizëm shumë popullor e që lidhet përherë me Poetin, sidomos duke aluduar tek emri i tij: “*Si ka thanë Fishta....*”, madje duke e përcjellë me disa vargje të kallëzimit “Dijjsja”, ku autori përshkruan jazin që mban gruaja për humbjen e të shoqit dhe “lehtësimin e zisë”, për të harruar bashkëshortin në (F/ V-7/ 180-181):

“Filloi jazin me e lehtësue ‘Dhima e burrit – dhimba e bërlylit’,

Edhe burrin ...me e harrue. Që dhemb fort e kalon shpejt,

☞ Ka pasë thanë nana e Bardylit: E me gjasë, që ka folë drejt...”

Është me rëndësi të tregojmë se aforizmi i nënvizuar “është qepur” brenda 6 vargjeve të këtij pasazhi përgjatë të cilëve (ndërtuar sipas parimit poetik më të thjeshtë “varg-fjali”, ajo ndjehet sa pa ardhur një frazeologji a shprehje tjetër, e cila do të rimarrë ngarkesën stilistike që deri aty e bart thënia (sentenca) e Poetit. Aq e vërtetë vjen kjo shfaqje sintakse, sa 3 njësitë e fundit predikative të fragmentit së sjellë këtu, dalin me hipotaksë dhe varen prej sentencës së thurur me elipsë nga Fishta, duke bërë që maksima të “shkrihet” brenda gjithë krijimit poetik. Me një sqarim më të gjerë, dëshirojmë të vëmë në dukje se kjo thënie paremiologjike, në një kontekst tjetër, bie fjala, në një ngushëllim (kryeshëndosh) për vdekje, në hapësirat e Malësisë dhe gjithë Veriut, përdorimi do të shoqërohej, së paku, me një nënqeshje – aq e pavend në ceremoni të tilla serioze; dhe kjo ngjet jo aq nga përmbajtja, sa nga fakti se në disa breza, njihet edhe fabula e kallëzimit *Dijjsja*, edhe autori me satirën e tij therëse e sarkastike. Në poemën “GB”, shprehjet frazeologjike shfaqin edhe një epokë, një mendësi, një kulturë dhe mënyrë jetese të mjaft personazheve. Nëse vështrojmë me vëmendje pjesën e parë të poemës që cituam “GB”, veprojnë: Ministri – Drejtori A – Babatasi, të cilët janë diferencuar në treguesit e shënuar më lart edhe nëpërmjet shprehjeve paremiologjike dhe frazeologjizmeve; kështu:

Për Ministrin veçojmë:

- *vë në qesti* – vë në tallje, luaj me dikë o përul një çështje a një punë të një personi; kurnjë dinjitar shtetëror mund të thoshte “vë në tallje, vë në lojë, tallet, demaskon”, etj.
- *mbyll varg e vistër* – mbyll njëra pas tjetrës (Do t’i mbylli varg e vistër/ Mbasi ndodhë kam unë ministër) f. 20.

Për Drejtorin A, B

- *s’njët morali* (i fes së krishterë) – nuk ngjit, nuk zë vend, nuk vlen;
- *mban në qark* – mban në rreth, mban sipas rregullit e

formë përmbledhjesh si * Taralloqja – (torollak-u): E trasha, E shushatura, Teveqelja, vepra të veçanta. Shkruan F.Leka se, për maksimat është e njohur vepra e francezit La Rochefoucauld, e vitit 1664 “Reflektime ose sentenca e maksima morale”. Të tjerë shkrimtarë janë bërë të njohur me thënie të tilla, sikurse na del në letërsinë tonë, Gjergj Fishta: “Unë jam Pater Gjergj Fishta/që shkon popullit tuj i njitë bishta”. Për fjalorin *Garzanti*, maksimat janë fjali (thënie), që përmbajnë shprehje norme jetike aq të sintetizuara; termi vjen nga latinishtja mesjetare “maxima”– *sententiam*, me kuptimin, fjali më e rëndësishme.

*Lat. “Mes trojanëve dhe tirëve nuk shoh se ka ndonjë dallim.”

* duqe – emër në nr. shumës - hejbe

¹² Leka, Ferdinand. Fjalor i termave të letërsisë, Infobotues, 2013, f. 240. Shpjegohet termi si vijon: “*lat. maxima (angl.maxim, fr. maxime, it. massima)*, por që i jepet një vlerë përgjithësuese. Maksimat i gjejmë të shprehura në veprat e shkrimtarëve, të filozofëve, të mendimtarëve ose në

ligjeve (tue mbajt n'qark ligjet e

- shtetit);
- *mbytë në det kulihum* (Franga ar ne vjetë për vjetë/Kulihum i mbysim n'det) – hedhim,
- shpenzojmë pa ekonomi, pa vlerë, i çojmë kot;

Herë-herë, Poeti sjell edhe aforizma që shtrihen kuptimisht në disa vargje radhazi, sikurse strofa katërshe e mëposhtme, e cila të kujton proverbin “*fshati digjet, k..... krihet*”:

“*Mbasi zjarri shtëpisë i asht dhanë
Pse mos t'ndezish n'të cigaren?...(f. 60)*”

bart kuptimin që të përfitojmë sa pa mbytur a djegur Shqipëria...

Një grup të veçantë të shprehjeve frazeologjike, të përdorura në veprat satirike të Gjergj Fishtës, janë ato që ndërtohen me lidhëzën “si”, për të cilat, Jani Thomai thekson se *këto shërbejnë si shprehje krahasuese të shfaqjeve të mëparshme kuptimore me vlerën e fjalës. Rrjedhimisht, mendojmë se duhen trajtuar si shprehje frazeologjike*^[13].

- *si këpurdhat n'shi* – sipas autorit që cituam, veprimi i shfaqur para këtij krahasimi vihet në përqsasje me çfarë është treguar nga njësia a segmenti përpara

“Ani çka se nuk del ma/ Me sa tjerat, që n'Shqipni
Kjo fletore. S'duhet gja/ / janë tue mbi *si këpurdhat
n'shi*”

Por ka modele shprehjesh, ku mungon lidhëza “si”, për arsye metri e theksimi, sipas ligjeve të poetikës, siç ngjet në shprehjen frazeologjike që duket se vjen si shndërrim që Poeti i ka bërë proverbit “*Kur bahet magjypi pashë, vret t'anë*” (të jatin); ndoshta Fishta e shformon në frazeologji më poshtë, pa lidhëzën “si”, edhe për shkak se, si klerik, nuk dëshiron ta sjellë në poezinë e tij këtë karakterizim racist, megjithëse në qytetin e Shkodrës kjo është fort e përdorur:

“T’gjithë rreziku i shqiptarisë,
Edhe ajo liria e shtypit
XThem unë, janë këto fletore, (si) *Ajo shpata n'dorë
t'magjypit*
Këto t'përkohshme përmujore, Që pret t'anë, pa mëshirë
aspak.” (f. 85)

“*Në rastet kur lidhëza krahasuese, vazhdon J.Thomai, nuk është e pranishme në mes të gjymtyrëve të togfjalëshit, sidoqë mund të nënkuptohet, lidhja frazeologjike është më e mundshme*”, si në vargun V të shembullit më sipër. Megjithatë, shpjegohet më tej se në të vërtetë nuk kemi shkrirje të plotë kuptimore të të dy gjymtyrëve për realizimin e një kuptimi (frazeologjik); këtë njësim, shkruan J.Thomai, *e pengon disi lidhëza krahasuese, e cila krijon një gjendje të tillë, ku në togfjalësh secila gjymtyrë realizon një nga kuptimet e saj, qoftë edhe të prejardhur dhe shuma e këtyre kuptimeve jep kuptimin e togfjalëshit*^[14].

- *s'çajnjë kryet* – nuk shqetësohen fare: “Ani pra Shqyphtarët e sotit/s'çajnjë fort kryet për punë t'Kastriotit (Fishta, “Gomari”..., 7) Ose, po këtu: “Mbasandej kah pak kah pak/ ka me u vu punëve kapak” (Fishta, “Gomari”, 48); Merret vesht, njana dhe tjetra/ kryet shoshoqes kanë m'ia lmuë”; “Se ata, besa m'ndigjo mue/Nuk i kanë shkrimet zanat.” mbledhur nga J.Thomai^[15].

Për Babatasin

- *më ke kamb e krye* – jam këtu kambë e krye, jam i tëri, me mend e me shqisa me ty;
- *me kuletë të shpueme* – me portofol pa lekë; këtu: me thesar të shtetit e buxhet bosh;
- *të ha mendja* – mendon për një gjë a veprim;
- *asht ba teneqe* – është bërë petë, s'ka më vlerë, është bosh; (financa asht ba teneqe);
- *nuk çon kandar* – nuk peshon, nuk ka vlerë: “fjala e tij nuk çon kandar” – flet pa baza;
- *kasha i ka qitë bar* – në kasë (thesar) ka mbirë bari, s'ka gjë brenda;
- *nuk asht ngaja* (ngêja) – nuk ka kohë në dispozicion për një punë a veprim;

Kur “shterrin” frazeologjizmat, autori merr e gjen forma letrare të tilla që karakterizojnë jo vetëm personazhe, por edhe situata e krahina, herë duke përdorur elipsën e foljeve, në gjenerimin e fjalive të paplota, herë duke treguar se nuk janë ashtu vetëm funksionarë qeveritarë prej një treve, po nga të dyja krahinat kryesore të vendit, si në pasazhin vijues:

*Der sa vetë – nga poshtë përprjetë, (me elipsë foljesh)
Kaq jam lodhë e këputë e lëmekë
Dorë prej punet t'këtij muzeu... (V-8/f.59)*

Babatasi vazhdon të shfaqet njeri dhe punonjës jo i pandryshur të karakterit të tij, edhe kur Ministri e emëron pa meritë në Muzeun Kombëtar, edhe kur dan me dhanë dorëheqjen; ai ruan edhe një gjykim të drejtë për gjendjen politike-ekonomike dhe drejtimin e qeverisë:

- *shihem me hanë pisk* – shihem jo mirë me dikë, pa harmoni e që nuk na shkojnë punët mbarë; këtë mendon Poeti për Babatasin, kur jep opinionin për marrëdhëniet italo-shqiptare: “*Pse Italia e Shqipnia/Me “hanë pisk”, po thonë, janë pa*”: sjell kuptimin se nuk i kanë më relatat të mira.
- *si qimja n'gojë* – ndërtim shprehjeje me lidhëzën krahasore “si”:

“*N'parlament kleri s'do t'shkojë/
Se ata janë si qimja n'gojë,*

Që s'del jashtë, as kapërdihet...! Përsëri në vëmendje të gjuhëtarit J.Thomai, nënvizojmë se autori i disa teksteve universitare dhe i monografive në lëmë të leksikologjisë, pohon që në rastet ku lidhëza krahasuese është e pranishme ose nënkuptohet dhe nuk e shpërbën njësinë frazeologjike,

¹³ Thomai, Jani. Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe (Monografi), Tiranë, 1981, f. 34.

¹⁴ Po ai, po aty, f. 34.

¹⁵ Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Thomai, Jani. Studime për gjuhën shqipe II, Frazeologjia gjuhësore, Tiranë, 2017, f. 70 – 71.

zakonisht ajo shënon edhe kufirin e tij nistor, për shembull (e ruaj) si dritën e syrit...^[16] Në shembullin tonë “si qimja n’gojë” kufiri, që përmend gjuhëtari ynë, i bie tek “Se ata janë...+ si qimja n’gojë”

Jo rrallë, Fishta merr e krijon edhe vetë frazema, kryesisht shprehje foljore, mbi bazën e gjedheve popullore, duke i vënë pranë e pranë në mënyrë simetrike, ashtu përballë njëra-tjetrës në dy vargje radhazi: Me mue Dibra merr e jep/Edhe kështu, po, qep e shkep...(f.92)

Në kohën kur në skenën e poemës dramatike, vjen e hyn personazhi me emrin përgjithësues *Katundari*, në faqen 62 të veprës, ndërton edhe regjistri i frazeologjizmave: janë shprehje të tabanit popullor, të njeriut të vuajtur për bukën e gojës, që e nxjerr jetesën me mundim e që paguan taksa dhe, pikërisht për taksat e tij “vergjji” – siç quhej e paguhej edhe në periudhën e pushtimit osman – prandaj autorit i duhet të zbrësë me këmbë në tokë, për të vënë në gojën e këtij tiranasi që banon në fshat, shprehje të mençurisë së popullit, shprehje të përvojës së tij; andaj dhe gjejmë të tilla, si:

- *m’ka mbetë kuleta thatë* – kam ngelur pa para, është tharë kuleta; autori e ka shtrirë në dy vargje përmbajtjen e kësaj shprehjeje: “Me gjithë këta, mbasi kuleta./ Thatë m’ka ngelë mue t’mjerit n’gji/ E me la kam do vergji./ S’kam çka baj: më jep çka t’duesh vetë...(f. 64).

Shfaqet edhe Autori vetë, me Shprehjet dhe frazeologjizmat aq të pasura e të qëlluara, si

- *sa pare ju ban gjaku* – çfarë vlere kini, sa ju çmojnë;
- *me iu dhimbtë gurit e drunit* – me pasë gjithkush dhimbje për ta;
- *ju njoh shpirtin deri në palc* – ju njoh deri në thelb, ju njoh në çdo gjë; jua di të gjitha;
- *vë në konop* – vari njerëz, dënoj me vdekje;
- *me u shtrve nën kambë* – me u bindë, me u disiplinue ndaj ligjeve e shtetit;

Me një shikim të vëmendshëm, lexuesi dhe një kërkues i kujdesshëm, mund të vërejë dallime jo veç në mbarë verbën e secilit prej personave që rreshtuam: nga Ministri, Drejtorët A, B, Babatasi, Katundari dhe vetë Autori, por edhe vetëm duke u bazuar në përdorimin e njësisë frazeologjike; kështu Ministri flet si një zyrtar i lartë e dinjitar shteti dhe merr e gjen frazema që i gjykon në pajtim me serën e pozitës së tij si dhe me klaturën; Drejtorët, po kështu, përpiqen të zgjedhin njësi frazeologjike të qëlluara; Babatasi flet e mendon e përzgjedh frazeologji, nëse mund të themi me një shprehje – me këmbë në tokë, mjaft reale; Katundari sikur i ka të gatshme në gojë çfarë thur e shoqëron me njësi të tilla, në të cilat bie në sy singeriteti e thjeshtësia kumtuuese, kurse Autori del në rolin e të “gjithëditurit”, prej të cilit frazeologjizmat mbahen për më intelektuale, etj.

Në mbyllje të kësaj vjeljeje të pjesshme prej poemës “Gomari i Babatasit”, do vëmë re se Fishta e ka vazhduar poemën edhe me Pjesën II, titulluar “Visku i Babatasit”, në të cilën satira shpërthen më thekshëm edhe me sarkazëm, që nga emrat e personazheve. Mendojmë se kulmin e arrin satira e Poetit, sidomos, në aktin II, me titull “Neoshqiptarët” (një emërtim

analogjik me *neoturqit* - Turqit e Rinj), në mënyrë të veçantë me idiomën dialektore jugore (toske) të Ismet Efendisë, Koços, Dallkautut, Daut Efendisë – të gjithë këto në raport me monologët e Babatasit, veprimtarit të shquar të Arsimit shqiptar, Mati Logoreci dhe vetë autorit.

Kjo satirë u shkrua në 4 ditë, sipas vetë Fishtës dhe nga fjalët e Poetit mësojmë se *pjesa e dytë, për arsye prudence, deri më sot nuk është botuar ende*^[17]. Ngjarjet e përshkruara janë reale dhe të niveleve të larta qeveritare të kohës në vitet 1920-1924, kur dhe parlamenti shqiptar u shpërnda dhe në post erdhën fanolistët. Sipas biografëve, pas poemës “GB” dhe “VB”, Fishta nuk u muar më me krijime në satirë; duket se iu kushtua përfundimisht lëmimit dhe përkryerjes së veprës më të madhe epike “Lahutës së Malcis”, të cilën e mbylli më 1937.

4. Përfundime

Në këtë punim është vënë në dukje se tek Fishta, jo vetëm përdorimi i frazeologjizmave është i ndryshën sipas gjinive e llojeve letrare, bie fjala, nga lirika tek satira, nga epika tek dramatika, por këto njësi bëjnë dallim edhe nga prania e denduria, edhe sidomos, nga përmbajtja e tyre.

Dimë që françeskani Gjergj Fishta krijoi në të gjitha gjinitë e njohura letrare: nga Lirika, Epika e Dramatika, duke na lënë një trashëgimi të pasohë në letërsinë shqiptare. Nuk jemi zgjatur në dhënien e personalitetit letrar të tij, pasi ai njihet tashmë prej botimeve dhe ribotimeve të shumta, deri edhe në publikimin e opusit të plotë të veprave nga Enti Botues “Fishta” i Lezhës; por na u duk e drejtë njohja me burimet e gjuhës popullore, ku u formua dhe u pasurua poeti: nga vendlindja e tij Fishta dhe mbarë treva e Zadrimës. Kjo hapësirë dhe jeta në Kuvendin Françeskan të Shkodrës, si dhe shërbimi në pak fshatra të Malësisë, deri edhe në Lezhë e Gomsiqe, mendojmë të kenë qenë burimet e pashtershme të idiomës aq të pasur të verbit fishtjan. Në përfundim, është thënë nga kritika jonë zyrtare se Fishta është aq i shquar në Epikë, sa edhe në Satirë, kështu që në veprat e kësaj gjinie të fundit u vështrua roli i frazeologjizmave në satirë dhe sarkazëm, sidomos për karakterizimin e personazheve komike, në stutuata komike dhe veprime komike e në shfaqjen sociale të tyre, deri në demaskim të skajshëm. Mbështetje për këtë kanë qenë veprat “Anzat e Parnasit”, dalë në fillim të shekullit XX (1907) dhe poema në dy pjesë e viteve 1930 “Gomari dhe Visku i Babatasit”.

5. References

1. Çapaliku S. Fishta satirik, Shtypshkronja Volaj, Shkodër, 1995.
2. Fishta GJ. Shqyptarët dhe të drejtat e tyre, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1920.
3. Fishta GJ. Vepra – 7, Botimet Fishta, Lezhë, 2004.
4. Koliqi, E. Shkolla letrare e françeskajvet, L’Albanie librë, korrik, 1956.
5. Leka F. Fjalor i termave të letërsisë, Infobotues, 2013.
6. Migjeni. Migjeni, Shtëpia Botuese. Naim Frashëri, Tiranë, 1988.
7. Thomai J. Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe, Monografi, Tiranë, 1981.

¹⁶ Thomai, Jani. Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe, Monografi, Tiranë, 1981, f. 34.

¹⁷ Fishta Gjergj. Vepra – 8, Botimet Fishta, Lezhë, 2004, f. 207.

8. Thomai J. Studime për gjuhën shqipe II – Frazeologjia gjuhësore, Tiranë, 2017.